



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. Dr. Ramadan Zejnullahu

Nr. Prot.: 577

Datë: 6/3/2015

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 2.3.2015, mori këtë:

## VENDIM

### I

Për lejimin e afatit të prillit, si afat plotësues, për organizimin e mbajtjes së provimeve. Në këtë afat studentët mund t'i paraqesin dy provime. Provimet e afatit të prillit mbahen në periudhën 29 mars – 11 prill 2015. Gjatë afatit të provimeve nuk do të mbahet mësimi, ndërsa semestri veror i vitit akademik 2014/15 do të vazhdojë deri më 10 qershor 2015.

### II


Obligohen të gjitha njësitë akademike-fakultetet e Universitetit të Prishtinës që të realizojnë mbajtjen e dy provimeve në muajin prill, si në pikën I të këtij vendimi dhe studentëve të cilët kanë përfunduar ligjeratat e vitit të fundit të studimeve përkatësisht absolventëve të i'u mundësohet organizimi i mbajtjes së një provimi, provim ky nga viti i fundit i studimeve. Provimi për absolventët organizohet në muajin maj 2015 dhe atë gjatë vikendit të parë të këtij muaji.

### III

Organizimi i mbajtjes së provimeve si në pikën I dhe II të këtij vendimi lejohet për këtë vit akademik (2014/15) ndërsa për vitin e ardhshëm akademik për çështje të tilla do të vendoset konform Ligjit për Arsimin e Lartë dhe konform Statutit të UP-së përveç nëse ndryshim-plotësimet eventuale të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Statutit të UP-së parashohin ndonjë dispozitë tjetër në raport me këtë çështje.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së
2. Fakulteteve
3. Zyrtarit ligjor të UP-së



REKTORI

Prof. dr. Ramadan Zejnullahu